



Kanton Zürich  
Bildungsdirektion  
Volksschulamt

# Informacion për prindërit

Gjermanishtja si gjuhë e dytë (DaZ)





Të dashur prindër,

Mbi 40% e nxënësve dhe nxënëseve në Kantonin e Cyrihut në familjet e tyre flasin një tjetër gjuhë nga gjermanishtja. Ndër qëllimet e shkollës fillore është që edhe të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të dinë mjaftueshëm gjermanisht aq sa të jenë në gjendje ta përcjellin mësimin. Sipas nevojës, shkolla i ndihmon nxënësit edhe me mësimin e gjermanishtes si gjuhë e dytë (DaZ).

Në vijim gjeni informacione se si i ndihmon shkolla fëmijët dhe të rinjtë në mësimin e gjermanishtes si gjuhë të dytë.



## Si i ndihmon shkolla fëmijët në mësimin e gjermanishtes si gjuhë e dytë?

### Kopshti i fëmijëve:

- **Gjermanishtja si gjuhë e dytë (DaZ) në kopsht**  
Fëmijët, të cilët dinë vetëm pak apo nuk dinë fare gjermanisht, përkrahen individualisht apo në grup nga një mësuese apo mësues i kualifikuar i gjermanishtes si gjuhë e dytë. Fëmijët e tillë e kanë këtë përkrahje të paktën nga dy leksione në javë. Leksionet e gjermanishtes si gjuhë e dytë mbahen në mënyrë të integruar gjatë mësimin në kopsht.

### Cikli i ulët dhe i lartë

- **Gjermanishtja si gjuhë e dytë – mësimi fillestar**  
Fëmijët dhe të rinjtë, të cilët migrojnë në Kantonin e Cyrihut me njohuri të pakta apo pa njohuri fare nga gjermanishtja, marrin çdo ditë mësim nga gjermanishtja si gjuhë e dytë në një grup apo në një “Klasë pranuese” (“Aufnahmeklasse”). Qëllimi është që të përfitojnë njohuritë themelore nga gjermanishtja aq sa të jenë në gjendje që në mënyrë aktive të ndjekin mësimin në një klasë të rregullt.

### – Gjermanishtja si gjuhë e dytë (DaZ) – mësimi i avancuar

Nxënëset dhe nxënësit, të cilët kompetencën e tyre të gjermanishtes duhet ta zhvillojnë dhe thellojnë edhe më tej, marrin mësim nga “Gjermanishtja si gjuhë e dytë – mësimi i avancuar” në të paktën dy leksione në javë.

Në rast se një nxënëseje apo një nxënësi i duhet përkrahja në mësimin e gjermanishtes, shkolla vepron si vijon:

- Në rast se personeli mësimor apo Ju si prind keni përshlytjen se fëmija Juaj ka nevojë për përkrahje, kujdestari i klasës së fëmijës Tuaj ju fton në një bisedë vlerësuese mbi “Gjermanishten si gjuhë e dytë”. Në këtë bisedë Ju dhe mësuesit pjesëmarrës merreni vesh për atë se çfarë përkrahjeje i duhet fëmijës Tuaj. Në rast të mospajtimeve vendos Komisioni Shkollor.



- Më pastaj, mësuesja apo mësuesi i gjermanishtes vendos për secilin fëmijë individualisht qëllime përkrahjeje dhe i ndihmon ata në mësimin e gjermanishtes.
- Edhe mësuesja apo mësuesi i klasës i ndihmon fëmijës në mësimin e gjermanishtes dhe kujdeset për atë që fëmijës gjatë mësimit t'i jepen detyra në përputhje me njohuritë e tij të gjermanishtes.

### Çka mund të bëjnë prindërit?

- Tregoni fëmijës se si gjuha e tij e parë, ashtu edhe gjuha gjermane janë të vlefshme dhe të rëndësishme.
- Ju ndihmoni në zhvillimin e mirë gjuhësor të fëmijës, nëse me fëmijën Tuaj flisni shpesh për tema të ndryshme dhe atë në gjuhën që e zotëroni më së miri – dhe kjo është zakonisht gjuha e parë.
- Nxisni kontaktin e fëmijës Tuaj me gjuhën gjermane. Fëmija Juaj mëson shumë gjermanisht nga kontaktet me fëmijët gjermano-folës dhe atë në fushën e lojës, në grupet e lojës, në shoqatat sportive, në strehët ditore, në «Pfadi» etj.
- Merrni së bashku me fëmijën Tuaj rregullisht libra për fëmijë, audio-tregime, lojëra mësimore dhe medime audio-vizuale nga biblioteka e lagjes Tuaj apo e komunës Tuaj. Shikoni me fëmijën Tuaj libra të ilustruar, lexojini libra atij, kujdesuni për atë që fëmija Juaj të lexojë shumë libra.
- Dërgojeni fëmijën Tuaj në një Kurs të gjuhës dhe të kulturës amtare (shikoni informacione të tjera nën shkurtesën HSK), nëse ekzistojnë kurse të tilla në gjuhën Tuaj të parë. Kështu fëmija Juaj do të mund të mësojë të lexojë dhe të shkruajë edhe në gjuhën e parë. Dytëgjuhësia mund të jetë një përparësi.
- Kujdesuni për atë që fëmija Juaj rregullisht t'i zgjidhë detyrat e shkollës në një vend të qetë.
- Mbani kontakt të rregullt me mësuesen apo mësuesin e fëmijës Tuaj. Flisni hapur me të për situatën e tij gjuhësore dhe atë mësimore si dhe për atë se si ndihet fëmija Juaj.

### Informacione të tjera

Informacione të hollësishme gjeni në broshurën «Deutsch als Zweitsprache in Aufnahmeunterricht und Aufnahme-klasse» («Gjermanishtja si gjuhë e dytë në mësimin pranues dhe në klasën pranuese») në:

[www.zh.ch/daz](http://www.zh.ch/daz)

Informacione mbi kurset e gjuhës dhe të kulturës amtare (HSK), si për shembull adresat kontaktuese dhe informacione mbi ofertat, i gjeni në

[www.vsa.zh.ch/hsk](http://www.vsa.zh.ch/hsk) dhe në [www.hsk-kantonzuerich.ch](http://www.hsk-kantonzuerich.ch)

### Udhëzime për prindërit mbi librat për fëmijët që rriten me shumë gjuhë:

- Nodari C./De Rosa R. (2003), «Mehrsprachige Kinder» («Fëmijët shumë-gjuhësorë»), një manual për prindërit dhe personat e tjerë ndërlidhës. Bernë: «Haupt.»
- Cathomas R./Carigiet W. (2008), «Top-Chance Mehrsprachigkeit. Zwei- und mehrsprachige Erziehung in Familie und Schule» («Top-shansi: Shumë-gjuhësia. Edukimi dy apo shumë-gjuhësor në familje dhe në shkollë»). Bernë: «Schulweg»